



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/09/23
Datë: 21.09.2023 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e nëntë (9) - e rregullt 2023 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 27.09.2023, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024 / 2026;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ri-alokim të mjeteve në kuader të kategorisë së shpenzimeve kapitale ;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Post: 2-955/8083
Një. Grë: 8
Nr. i Faq: 1
Data: 01/09/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	01.09.2023
PËR/ZATO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe në Kuvendin Komunal shqyrtimin dhe miratimin e Buxhetit për periudhën 2024/2026.

I nderuar,

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (L.MFPP) nr.03/L-048, neni 20, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 24 dhe ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, neni 23,24 dhe 25 dhe në bazë të limiteve nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me qarkoren e dytë buxhetore 2024/02, kërkojmë që të shqyrtohet dhe të miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025 dhe 2026.

Më respekt!

Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2024 -

Tabela 4.1 (Projekt) Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2024

Kod.	Komun	Kod.i progra mit/nen progra	Prog ram	Nën- program	Përshkrimi	Stafi 2024	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione t dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total Buxheti 2024
636	Junik				TOTAL SHPENZIME	167	1,445,893	246,660	38,500	62,000	406,784	2,199,837
					Grantet Qeveritare	167	1,445,893	241,660	38,500	30,000	235,728	1,991,781
					Të hyrat vetanake		-	5,000	-	32,000	171,056	208,056
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.1	160				Zyra e Kryetarit	8	85,404	9,300	150	62,000	-	156,854
					Grantet Qeveritare	8	85,404	9,300	150	30,000	-	124,854
					Të hyrat vetanake		-	-	-	32,000	-	32,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.1.1	16020				Zyra e Kryetarit	8	85,404	9,300	150	62,000	-	156,854
					Grantet Qeveritare	8	85,404	9,300	150	30,000	-	124,854
					Të hyrat vetanake		-	-	-	32,000	-	32,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.2	169				Zyra e Kuvendit Komunal	-	134,812	4,000	-	-	-	138,812
					Grantet Qeveritare		134,812	4,000	-	-	-	138,812
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.3	163				Administrata dhe personeli	14	99,221	43,300	7,200	-	13,000	162,721
					Grantet Qeveritare	14	99,221	43,300	7,200	-	10,000	159,721
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	3,000	3,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.3.1	16320				Administrata	14	99,221	43,300	7,200	-	13,000	162,721
					Grantet Qeveritare	14	99,221	43,300	7,200	-	10,000	159,721
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	3,000	3,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.6	175				Buxheti dhe financat	9	66,136	8,200	100	-	-	74,436
					Grantet Qeveritare	9	66,136	8,200	100	-	-	74,436
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.6.1	17520				Buxheti	9	66,136	8,200	100	-	-	74,436
					Grantet Qeveritare	9	66,136	8,200	100	-	-	74,436
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.7	180				Shërbimet publike, mbrojtja civile,	8	54,494	35,800	13,850	-	85,000	189,144
					Grantet Qeveritare	8	54,494	35,800	13,850	-	45,000	149,144
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	40,000	40,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.7.1	18020				Infrastruktura rugore	8	54,494	35,800	13,850	-	85,000	189,144
					Grantet Qeveritare	8	54,494	35,800	13,850	-	45,000	149,144
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	40,000	40,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.8	195				Zyra komunale për komunitete dhe	1	8,034	-	-	-	-	8,034
					Grantet Qeveritare	1	8,034	-	-	-	-	8,034
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	-
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.10	480				Zhvillimi ekonomik	10	63,514	10,000	400	-	129,458	203,372
					Grantet Qeveritare	10	63,514	10,000	400	-	64,402	138,316
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	65,056	65,056
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.10.1	48020				Planifikimi i zhvillimit ekonom	10	63,514	10,000	400	-	129,458	203,372
					Grantet Qeveritare	10	63,514	10,000	400	-	64,402	138,316
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	65,056	65,056
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.14	660				Planifikimi urban dhe mjedisi	7	53,618	16,860	-	-	159,326	229,804
					Grantet Qeveritare	7	53,618	16,860	-	-	104,326	174,804
					Të hyrat vetanake		-	-	-	-	55,000	55,000
					Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.14.1	66405				Planifikimi urban dhe inspeksi	7	53,618	16,860	-	-	159,326	229,804
					Grantet Qeveritare	7	53,618	16,860	-	-	104,326	174,804

				Të hyrat vetanake				-	-	55,000	55,000
				Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.15	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale			37	327,515	58,100	8,200	-	10,000	403,815
				Grantet Qeveritare	37	327,515	53,100	8,200	-	7,000	395,815
				Të hyrat vetanake		-	5,000	-	-	3,000	8,000
				Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.15.1	73025	Administrata			2	22,253	3,200	-	-	-	25,453
				Grantet Qeveritare	2	22,253	3,200				25,453
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.15.2	74200	Shërbimet e shëndetësisë primare			33	292,743	52,500	6,200	-	10,000	361,443
				Grantet Qeveritare	33	292,743	47,500	6,200		7,000	353,443
				Të hyrat vetanake			5,000			3,000	8,000
				Financimi i jashtëm						-	-
1.15.4	75595	Shërbimet sociale			2	12,519	2,400	2,000	-	-	16,919
				Grantet Qeveritare	2	12,519	2,400	2,000		-	16,919
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.16	760	Pagesat për performancë në shërbime			-	-	-	-	-	-	-
				Grantet Qeveritare						-	-
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.18	920	Arsimi dhe shkenca			73	553,146	61,100	8,600	-	10,000	632,846
				Grantet Qeveritare	73	553,146	61,100	8,600	-	5,000	627,846
				Të hyrat vetanake			-	-	-	5,000	5,000
				Financimi i jashtëm		-	-	-	-	-	-
1.18.1	92100	Administrata			5	35,754	4,500	-	-	-	40,254
				Grantet Qeveritare	5	35,754	4,500				40,254
				Të hyrat vetanake						-	-
				Financimi i jashtëm						-	-
1.18.3	93570	Arsimi fillor			50	373,113	39,500	5,000	-	10,000	427,613
				Grantet Qeveritare	50	373,113	39,500	5,000		5,000	422,613
				Të hyrat vetanake		-	-	-	-	5,000	5,000
				Financimi i jashtëm						-	-
1.18.4	94770	Arsimi I mesëm			18	144,278	17,100	3,600	-	-	164,978
				Grantet Qeveritare	18	144,278	17,100	3,600			164,978
				Të hyrat vetanake							-
				Financimi i jashtëm						-	-

Tabela 4.2 (Projekt) Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2024

Total							Kostoja Totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake
636	Junik	TOTALE SHPENZIMET KAPITALE					406,784.00	235,728.00	171,056.00
	920	Arsimi dhe shkenca					10,000	5,000	5,000
	93571	Arsimi fillor					10,000	5,000	5,000
						Rregullimi i infrastrukturës së oborrit të SHFMU E. Hoxha	10,000	5,000	5,000
							-		
	480	Zhvillim Ekonomik					129,458	64,402	65,056
	48020	Planifikimi i zhvillimit ekonomik					129,458	64,402	65,056
						Bashkëfinancimi i projekteve	102,458	49,402	53,056
						Ndërtimi i rrethojës dhe Rekonstruimi i oborrit të stacionit të autobusëve	7,000	5,000	2,000
						Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Lagja Pepsh, Krraku, Arifaj	20,000	10,000	10,000
							-		
	180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca					85,000	45,000	40,000
	18020	Infrastruktura rrugore					85,000	45,000	40,000
						Rehabilitimi i rrugëve lokale	20,000	10,000	10,000
						Vendosja e Kamerave të sigurisë në Komunën e Junikut	25,000	15,000	10,000
						Rregullimi i infrastrukturës për Deponin e mbeturinave inerte	20,000	10,000	10,000
						Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik në rrugët lokale	20,000	10,000	10,000
							-		
	660	Planifikimi urban dhe mjedisi					159,326	104,326	55,000
	66405	Planifikimi urban dhe inspeksioni					159,326	104,326	55,000
						Kanalizimi i ujërave të zeza lokacioni Moronicë, lagja Krasniq	9,326	9,326	
						Ndërtimi i sheshit të qendrës të Komunës së Junikut	150,000	95,000	55,000
							-		
	163	Administrata dhe Personeli					13,000	10,000	3,000
	16320	Administrata					13,000	10,000	3,000
						Zerimi i sallës së Kuvendit Komunal	13,000	10,000	3,000
							-		
	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale					10,000.00	7,000.00	3,000.00
	74200	Shërbimet e shëndetësisë primare					10,000.00	7,000.00	3,000.00
						Rekonstruimi i oborrit në QKMF	10,000.00	7,000.00	3,000.00

Tabela 4.2 Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2025

Total							Kostoja Totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake
636	Junik			TOTALE SHPENZIMET KAPITALE			505,854.00	330,281.00	175,573.00
		920	Arsimi dhe shkenca				100,000	70,000	30,000
		93571		Arsimi fillor			100,000	70,000	30,000
						Rekonstruimi i objektit numër 1 të SHFMU E. Hoxha	100,000	70,000	30,000
							-		
		480	Zhvillim Ekonomik				87,764	45,281	42,483
		48020		Planifikimi i zhvillimit ekonomik			87,764	45,281	42,483
						Bashkëfinancimi i projekteve	87,764	45,281	42,483
							-		
		180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca				213,090	150,000	63,090
		18020		Infrastruktura rrugore			213,090	150,000	63,090
						Rehabilitimi i rrugëve lokale	18,090	10,000	8,090
						Rekonstruimi i shtratit të lumit Erenik	130,000	100,000	30,000
						Vendosja e Kamerave të sigurisë në Komunën e Junikut	25,000	15,000	10,000
						Rekonstruimi i parkut "Ibrahim Rugova"	20,000	15,000	5,000
						Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik në rrugët lokale	20,000	10,000	10,000
							-		
		660	Planifikimi urban dhe mjedisi				50,000	30,000	20,000
		66405		Planifikimi urban dhe inspeksioni			50,000	30,000	20,000
						Ndërtimi i sheshit të qendres të Komunës së Junikut	50,000	30,000	20,000
							-		
		730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale				55,000.00	35,000.00	20,000.00
		74200		Shërbimet e shëndetësisë primare			55,000.00	35,000.00	20,000.00
						Blerja e Autoambulances me pajisjet përcjellëse mjeksore	55,000.00	35,000.00	20,000.00

Tabela 4.2 Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2026

[illegible]



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/09/23
Datë: 21.09.2023 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e nëntë (9) - e rregullt 2023 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 27.09.2023, ora 10⁰⁰.

Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024 / 2026;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ri-alokim të mjeteve në kuader të kategorisë së shpenzimeve kapitale ;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 08-02/23
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	31.08.2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tetë (8) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 31.08.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marim pjesë të 15 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leunora Shehu-DA, znj.Vjollca Qestaj-DBF, znj, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Zenun Shala DUKM

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK
5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Qershorit dhe Korrikut 2023,
3. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrje-shirjeve në komunën e Junikut,
4. Nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për ndryshim të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024,
5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2024,
6. Informatë lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor 2023/2024,
7. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2024/26 të Ministrisë së Financave,
8. Pyetje nga anëtarët e kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë rreth rendit të ditës nuk ka, e qes ne votim rendin e ditës të propozuar, kush është për? për 15 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, mungesa nuk ka të gjithë anëtarët e kuvendit janë prezent në sallë.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Qershorit dhe Korrikut 2023,

z.Shpejtim Gacaferi, fillimisht po e shqyrtojmë procesverbalin e muajit Korrik-2023 pasi që ju kam dërguar me kohë, me pastaj kur ta kemi nga një kopje të procesverbalit të muajit Qershor-2023 e shqyrtojmë dhe e miratojmë nëse jeni të gjithë dakord.

z.Zenel Maloku, përshëndetje për të gjithë, sa i përket procesverbalit të muajit korrik, nuk jam i kënaqur me këtë procesverbal sepse ne të nuk janë shkruar fjalët që janë thanë, kjo nuk është vërejtja e parë por e shumta herë që bëjë vërejtje, dhe besoj se në komune ka persona të aftë që mundën me e kryer ashtu siç duhet procesverbalin, nuk është mirë që njeriu që bënë një bisedë mos të shkruhet, konkretisht fjala është të fjalja e drejtorit ku bëhet fjalë rreth ndërtimit të urës në rrugën e fshatit Jasiq, kur është bërë pyetja sa ton beton do të futen në këtë urë, drejtori është përgjigjur $310m^3$ ndërsa në procesverbal është $342m^3$, ju ka bërë pyetje për hekur, drejtori është përgjigjur 28 ton e 900kg, në procesverbal nuk i kanë shënuar hiq 900kg, dhe sipas meje këto sene nuk janë të mira, çështja tjetër është me aq sa di se a me ke thënë ti kryesues apo kryetari me keni thënë se nuk ke nevojë me e vetë kaq fellë, kjo nuk është e shkruar hiq, kjo do duhet të jetë e shkruar, unë e di se si delegat kam të drejtën të pyes, por nuk kam të drejtën të ofendoj askënd, andaj kjo do duhej të jete e shënuar në këtë procesverbal.

z.Shpejtim Gacaferi, ne procesverbal në esence duhet te ketë përmbajtjen e diskutimit rreth një pike te rendit te ditës, nuk është e thënë te jete i tere diskutimin , por edhe përkundër kësaj ne çdo procesverbal e shqyrtojmë dhe e miratojmë ndonjë pa vërejtje por edhe ndonjë me vërejtje.

z.Leonard Lolluni, përshëndetje për te gjithë, fjalët qe i tha z.Zenel Maloku, mua me kujtohen se ato ashtu kanë qenë, ti kryesues ke ndërhyrë edhe pse nuk ke te drejtë te ndërhysh dhe ke thënë se nuk ke nevojë te pyetesh aq fellë, dhe kjo fjali është dashur te shkruhet ne procesverbal.

z.Shpejtim Gacaferi, vërejtje tjera nuk ka, e qes ne votim me këto ndryshime qe u ceken nga z.Zenel Maloku qe procesverbalin e muajt korrik-2023 te miratohet, kush është për? për 10 vota, kundër 2 vota dhe abstenim 3 vota, konstatoi se procesverbali i muajit korrik-2023 miratohet me vërejtjet e cekura.

3. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrje-shirjeve në komunën e Junikut,

Informatën e beri z.Besart Tofaj-nënkryetar i Komunës se Junikut, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e informoje anëtarët e kuvendi mbi mbarëvajtjen e procesit te korrje-shirjeve ne Komunën e Junikut.

4. Nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për ndryshim të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024,

Sqarimin dhe arsyetimin e vendimit për fillimin e procedurave për ndryshim te rregullores për tatimin ne pronën e paluajtshme për vitin 2024 e beri znj.Vjollca Qestaj, drejtoreshe ne DBF, e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë dhe me pas e sqaroi dhe e arsyetoj para anëtarëve te kuvendit, nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për ndryshim të rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka, e qese ne votim, nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për ndryshim të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024, kush është për? për 15 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për ndryshim të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024 u miratua.

5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2024,

Edhe sqarimin dhe arsyetimin e nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2024, e beri znj.Vjollca Qestaj drejtoreshe ne DBF.

z.Leonard Lolluni, a është planifikuar diçka te ndryshohet ne këtë rregullore apo do te mbetet e njejta.

z.Shpejtim Gacaferi, fillimisht ne sot marrim vendim për fillimin e procedurave me pas Kryetari formon komision dhe komisioni parasheh a do te këtë ndryshime a jo kjo rregullore dhe me pas vjen për miratim këtu ne kuvend, dikush tjetër nuk është paraqitur per fjale kështu qe e qes ne votim, nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2024, kush është për? për 15 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se nxjerrja e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2024, u miratua.

6. Informatë lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor 2023/2024,

Informatë lidhur me përgatitjen e vitit të ri shkollor 2023/2024 e beri z,Xhavit Velijaj, drejtor në DAKRS, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas i informoj anëtarët e kuvendit lidhur me fillimin e vitit te ri shkollor 2023/2024.

z.Leonard Lolluni, unë kam një pyetje, sa është numri i nxënësve qe e kanë regjistruar klasën e parë, dhe sa për informacion, ne “Dukagjin” ne asnjë librari nuk mundesh ti gjeni te gjitha tekstet shkollore.

z.Xhavit Velijaj, për ne klasën e parë për momentin i kemi te regjistruar 40 nxënës, por duke ditur se nuk i respektojnë afatet e parapara ligjore numri i tyre mund edhe te shtohet, mirëpo ne këto qaste i kemi vetëm 40 nxënës të regjistruar ku i kemi ndarë ne tri paralele, ndërsa sa i përket furnizimit me libra, ky nuk është problemi i yni, ne gjithmonë e kemi paraqitur si shqetësim furnizimin me libra ne komune tone sepse një librari qe merret vetëm me furnizimin me libra ne komunën tonë nuk kemi, është si miks librari, dhe ne e dimë se këtë radhë do te jetë sfidë për prindët qe ti furnizojnë fëmijët me libra këtë vit, dhe ne këtë mënyrë është një dështim i ministrisë për mos furnizimin me libra nxënësit si vitet tjera.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për te gjithë, unë desha te ndërlidhem me ndërtimin e objektit te ri te shkollës qe është ende duke u ndërtuar, ju thatë se ka shumë punë pa kryer, dhe unë po dua te di se a ekziston një afat kohor për përfundimin e te gjithave punimeve qe janë te parapara me kontratë, sa keni mare masa ju si komunë te operatori ekonomik qe punimet te kryhen me kohë, dua te ndërlidhem edhe me atë qe the furnizimi me libra është dështim i ministrisë, ajo nuk qëndron, ministria e ka ndalë një te keqe, siç dihet ministritë e kaluara për një nxënës për ta pajisur me libra kanë paguar 328€, ndërsa qeveria ka ndalë këtë të keqe qe taksat e taksapaguesit tanë mos te shkojnë ne adresë te gabuar, thatë po ashtu se e keni siguruar lëndën djegëse për dimër, ku e keni siguruar dhe kur do te vije ajo lënda djegëse?

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për te gjithë, desha te përgjigjem sepse kame informatë te saktë, është e vërtetë qe furnizimi me libra do të behet, aplikimi duhet te bëhet nga ana e prindërve ne platformën e-Kosova, dhe nuk do te këtë as një pengesë qe furnizimi të bëhet me kohë, ndërsa sa i përket objektit te ri te shkollës, ka një kontratë qe është e lidhur mes operatorit ekonomik dhe Ministrisë se Arsimit, kontrata është zgjatur prap për shkak te problemeve te implementimit, dhe

se unë mendoj se deri ne fund te shtatorit do te kryhen te gjitha punët dhe objekti i ri i shkollës do te jetë në disponim te vijimit te mësimi, ndërsa sa i përket furnizimit ne lëndë djegëse, ne kemi një kontratë dhe furnizimi me këtë lëndë do të bëhet me kohë.

z.Xhavit Velijaj, furnizimi me lëndë djegëse dru është kryer për Gjimnaz, ndërsa sa i përket furnizimit me “pelet” për shkollën fillore ne kemi bërë një kërkesë qe te kemi furnizim edhe për objektin e ri te shkollës dhe kjo është ne procedura te prokurimit dhe besoj se furnizimi do të bëhet me kohë.

z.Leonard Lolluni, desha te di nga drejtori, se ne sa paralele do ti ndaje nxënësit e klasës se parë.

z.Xhavit Velijaj, do ti ndajmë ne tri paralele.

z.Zenel Maloku, desha te di se mosha e pranimi ne klasën e parë a është nga gjashte vjeç , shtatë vjeç apo si, a ka moshë te caktuar qe me sa vjeç duhet te pranohen ne klasën e parë? Dhe çështja tjetër është, ne raportin e fundit qe keni bere keni thënë se nota mesatare ka dale 3.8 apo 4.0 nuk e di, por unë kisha thënë qe këtë vit bashkërisht te angazhohemi edhe me profesor qe nota mesatare te behet 5.00.

z.Xhavit Velijaj, sa i përket moshës se pranimi ne klasën e parë është e rregulluar, për parashkollorë është nga 5-6 vjeç, ndërsa për klasën e parë është nga 6-7 vjeç.

znj.Rajmonda Krasniqi. Përshëndetje për te gjithë, unë desha te pyes se a fillon mësimi zyrtarisht nesër e Premte datë 01.09.2023? sepse po jemi ne dilema se ne ora 10, apo 11 .

z.Xhavit Velijaj, nuk ka dilema kjo çështje është e vendosur ne bazë te udhëzimit administrativ dhe ky vit shkollorë fillon me 1 shtator 2023.

7. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2024/26 të Ministrisë së Financave,

Informatën e dha z.Arten Hamza zyrtarë i Lartë për Buxhet ne DBF, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë dhe me pas e informoj anëtarët e kuvendit mbi qarkoren buxhetores 2024/2026.

8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

z.Lulzim Gacaferi, desha te beje pyetje rreth lumit “Erenik”, ju e dini se ne ndërtimin e shtratit te lumit “Erenik” është investuar shume para, dhe gjendja momentale e këtij shtrati është katastrofale, dhe desha të di nga drejtori për kadastër dhe urbanizëm se a keni punuar ne atë drejtim qe shtrati i lumit “Erenik” te rinovohet, a keni mare masa ndaj atyre, te cilët kanë qenë te caktuar nga ish pushteti i kaluar për inspektimin e punimeve, punime këto që kanë qenë te përgjysmuara, dhe kur do te rinovohet dhe te punohet shtrati i lumit “Erenik”.

z.Zenun Shala, përshëndetje për te gjithë, ne jemi ne proces e sipër te përgatitjes projektin dhe se shpejti do te dele ne prokurim për tenderim ne gjatësi 4km, ndërsa sa i përket punëve qe janë

kryer nuk kemi mare kurrfarë masash administrative, vërshimet e fundit e kanë dëmtuar shumë shtratin e lumit Erenik dhe vlerësimi i këtyre dëmeve është deri ne 350000€ , me çka e kemi informuar edhe ministrinë e infrastrukturës për këto dëme.

z.Lulzim Gacaferi, drejtor thatë se nuk keni marë masa ndaj atyre që kanë inspektuar punët gjatë ndërtimit të shtratit të lumit Erenik, duhet ta dini drejtor se ne dhe ju marim pagë nga taksapaguesit e këtij shteti dhe e keni për obligim që të mereni me këta persona që pushteti i kaluar i ka zgjedhur të bëjnë inspektimin e këtyre punëve e që sipas informatave nuk kanë qene të profesionit të duhur që të bëjnë inspektime dhe për këtë arsye kemi një gjendje të tillë çfarë është sot të shtratit të lumit Erenik.

z.Leonard Lolluni, unë kame pyetje për drejtorin e shëndetësisë z.Fatos Shala, para tri jave ka ndodhur një aksident i vogël në Junik afër lokacionit "Livadhi i Madh" ku vajzat e z. Gëzim Krasniqi kanë pësuar aksident me motorr, fatmirësisht jo me fatalitet, mirëpo sipas asaj që prindi me ka informuar, ai ka thirrë në QKMF, dhe i kanë thënë se ne nuk kemi me çka me ardhur atje, përkundër kësaj ai i ka sjelle vet në QKMF, vajzat dhe kur i ka sjelle në QKMF i kanë thënë, masi i ke pruar vet deri këtu qojë vete për Deçan apo për në Pejë, ky është një gjest jo i mirë dhe nuk guxon të ndodhë.

z.Fatos Shala, përshëndetje për të gjithë, unë informatë prej prindit të vajzave nuk kam pasur, por kam pasur një informatë nga një mik i këtij prindi për këtë ngjarje, rasti ka ndodhur me datën 10.08.2023 në ora 14:17 minuta, dhe unë menjëherë e kam informuar dr.Ali Kuçin, i cili përkundër se ishte në pushim vjetor i ka thirrur shoferët e auto ambulancës që të jenë të gatshëm, dr.Alisë i kanë propozuar që të shkojë deri në Jasiq dhe nga aty ti bart me autoambulancë pacientët, mirepo dr.Alia është një profesionist i madh dhe për mos më i maltretuar pacientët nga një makine në një makine tjetër, kjo ka qenë ndërsa sa i përket asaj pjese jo qojë vete për Deçan apo Pejë, për këtë pjesë nuk kam informatë.

z.Leonard Lolluni, unë nuk dua të futem me fellë sepse prindi i ka inxhizimet se me ke ka biseduar por ajo çka po dua është që të merni masa dhe të mos na ndodhin me kësaj rastesh.

z.Zenel Maloku, unë pyetje nuk kam por kam një ankesë rreth komunës dhe QKMF_se, i kemi pasur dy raste që kanë ndodhur në bjeshkë që është dashur të shkojnë mjeket por nuk kanë pasur me çka të shkojnë, e kam çekur në këtë sallë të kuvendit që QKMF_ja ta merrë një automjet të Komunës që është i përshtatshëm për rrugët malore dhe të bjeshkës dhe ta ketë në dispozicion të kohen, në jemi dëshmitar se kemi për ditë persona që shkojnë për bjeshkë dhe mund të kemi prap raste të tilla por që të jenë me afër çdo rasti QKMF duhet ta ketë një auto veturë të këtillë, kjo ishte edhe ankesë por njëkohësisht është si kërkesë që QKMF_ja ta ketë një automjet të tillë, çështja tjetër është për tu përgëzuar komuna i ka vendosur dy shenja komunikacioni të xhamija, me erdhe mirë kur i pashë por në anën tjetër u zhgënjeva se pse nuk i keni vendosur edhe në pjesët tjera, a nuk keni para apo çka është në pyetje.

z.Xheme Tofaj, përshëndetje për të gjithë, në lagjen Gacafer, me herët ka pasur "Polic të Vdekur" për ngadalësimin e shpejtësisë, ato tash më i ka hekur dikush, a keni informatë se kush i ka hequr dhe a do të merni masa që të rivendosni sepse në atë pjesë shoferët po i ngasin me shpejtësi të lartë automjetet dhe po paraqesin rrezik për banorët e kësaj lagje.

z.Ruzhdi Shehu, policia do të jetë në vëzhgime edhe në atë lagje, tash i kanë shtuar kapacitete dhe se besojë se do ta vëzhgojnë lagjen Gacafer edhe me shume, ndërsa sa i përket rivendosjen e ketyre "policeve të vdekur" nuk kemi parapare që ti ri vendosim.

znj.Rajmonda Krasniqi, pata një kërkesë për drejtorin e shërbimeve por ai nuk është prezent kështu që po ju drejtona juve kryetar, të rruga afër shtëpisë së z.Ismet Hebibi në trotuar është një gropë e hapur, por e mbuluar nga bari, dhe unë dje isha me djalin duke ecur në atë pjesë po të mos isha unë afër djalit dhe të binte në atë gropë se ishte koka e thellë, unë kisha kërkuar që ta shikoni dhe të merrni masë para se dikush ta pëson ndonjë lëndim.

z.Lulzim Gacaferi, edhe unë pata pyetje për drejtorin e shërbimeve por ai nuk është këtu, kështu që po i drejtohem kryetarit, a i keni vërejtur shume rrugë nëpër komunën e Junikut janë të ngushtuara nga shkurret në të dy pjesët e rrugës, dhe kanë pamundësuar shndërrimin e dy automjeteve, këto rrugë janë rrugë lokale a keni paraparë që këto rrugë të i mirëmbani, ndërsa çështja tjetër është, në trotuarin nga qendra për në lagjen "Krasniq", ka shtylla elektrike mu në mes të trotuarit, dhe unë kërkoj që ti shikoni mundësit që ato shtylla të largohen nga trotuari dhe të vendosen diku tjetër.

z.Ruzhdi Shehu, ne jemi duke e dizajnuar një projekt për qendrën, ku ne të janë të parapara të gjitha detajet, qofte për trotuarin, ndriçimin të gjitha, dhe si projekt është në përfundim e sipër, tash po presim me gjete edhe fonde dhe me të kontraktimin. çështje tjetër ka të bëjë me autoambulancën, a i keni bërë servisim këtij autoambulancës, nëse i keni bërë është diçka shume e mirë por ajo çka mua po më intereson është, shoferi që nga atë autoambulance a ka kryer trajnim sepse ajo është autoambulance dhe automjet privat, drejtor sa keni punuar që QKMF_ja të jete funksionale 24 ore, për aparaturnë rëntgen e kemi diskutuar në këtë kuvend me dhjetë here, kur do të jete funksional, por nëse nuk mundeni ta bëni funksional, a keni paraparë që atë aparaturnë ta shitni që ta mëre ndonjë kompani, që mjetet ka kjo shitje të marim dhe të vendosim në ndonjë sektor tjetër ku është nevoja.

z.Fatos Shala, sa i përket autoambulancës ajo është servisuar, është servisuar komplet me gjithë gomë, para dy apo tri javë, tani është në gjendje shume të mirë, kemi nevojë për një autoambulance por edhe të shoferave, dhe në mënyrë kemi hapur konkurs për pranimin e shoferit të ri dhe në kushtet e kërkuar për pranim nuk ka patur kushte tjera përpos të këtyre patentën për kategorinë b e caktuar, pyetje rreth ndihmës së parë dhe dokumentet tjera si çdo punëtor që rekrutohet, ndërsa sa i përket funksionimit të QKMF-se 24 ore, çështja tash është në prokurim dhe prokurimi ka afatet e veta kështu që ne jemi duke pritur.

z.Leonard Llojuni, sa i përket QKMF-se ka shume ankese, por unë do të them atë që mua vete më ka ndodhur me djalin të qytetit është njëvjeçar dhe kam pasur për ta vaksinuar, dhe kur kam shkuar aty më kanë thënë se mjekja nuk është dhe ka shkuar në pushim dhe nuk ka zëvendësuar, drejtori duhet të planifikojë se kur dikush prej stafit është në pushim duhet të zëvendësojë, ndërsa sa i përket vendosjes së shenjave të komunikacionit, keni vendosur stop aty të rrugës së shtëpisë time, mirë që e keni vendosur nuk jam kundër por në një rrugë me poshtë e që ka kycje me të rrezikshme në rrugën kryesore nuk keni vendosur asnjë shenje.

z.Fatos Shala, orarin e QKMF_se e bene drejtori i QKMF_se, e sa i përket vaksinimit, kam informata nga stafi se stafi i QKMF_se i thrasin prindit qe ti bine fëmijët e tyre për vaksinim, por sipas kësaj qe thua rasti është ma ndryshe dhe do ta hulumtoj.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për te gjithë, unë pata një pyetje lidhur me rrugën e re qe ka përfunduar dhe qe ishe investimi me madhe ne shume prej 140000€, rruga “Bajraktar-Gaxherr”, dhe menjëherë pas një jave kemi një prerje te asfaltit, a e ka njoftuar ai person komune për prerje te asfaltit, a ka marë leje nga komuna, a ka mundur qe ky kanal te ndërtohet para se te behet asfaltimi, për mua kjo është diçka e keqe sepse sapo e përfunduam një rruge filloj prerja.

z.Lulzim Gacaferi, desha te pyes lidhur me ndërtimin e pjerrinës(urës për persona me nevoja të veçanta) qe është duke u ndërtuar këtu ne oborrin e objektit te komunës, a ju ka ra ne sy ky ndërtim qe ishte duke e çoroditur ter vendin, e kishte shëmtuar komunën e Junikut, dhe ky ndërtim është për te ardhur me te vërtetë keq, kush është mbikëqyrës i këtyre punimeve dhe kush e mere përgjegjësinë për këto punime, unë kërkojë nga ju qe operatorit ekonomik qe është duke bere këto ndërtime ti ndërpriten punimet.

z.Zenun Shala, ky është investim i BE_se, ata e kanë berë përzgjedhësin e operatorit ekonomik, ata e kanë ne mbikëqyrje ketë projekt, e janë ka qen qe ti hapim dyer dhe ta pranojmë ketë projekt, dhe ne kur e kemi parë se si është duke u kryer këto ndërtime e kemi ndërprerë punën, e kemi njoftuar punëkryesin dhe menagjerin e projektit se janë ndalë dhe nuk mundet te vazhdohet kështu siç janë duke punuar.

z.Zenel Maloku, desha te pyes lidhur me emërtimin e rrugëve, emërtimi i rrugëve siç e dimë ka përfunduar por me intereson te di se kur do ti vendosni tabela me emra te rrugëve.

z.Ruzhdi Shehu, shenjëzimi i emërimit te rrugëve është ne proces, te dhënat se si janë te emërtuar rrugët i kanë marre dhe po presim qe me ardhur me i vendos ato tabela, edhe kjo do të financohet nga fondi i BE_se dhe besoj se shumë shpejtë do te fillojnë me ketë projekt jo vetëm tek n por ne te gjitha komunat ku nuk ka përfunduar shenjëzimi i emërimit te rrugëve.

z.Lulzim Gacaferi, kulla qe është ndërtuar ne “Moronicë”, ne e dimë se ende nuk ka përfunduar dhe po dua te di se ku qëndron problemi se per se nuk ka përfunduar, dhe ekziston kontrate qe tregon afatin se kur do te përfundon ky ndërtim, po ashtu për objektin valavica qe gjendet afër shtratit lumit erenik, ne e dime se me pare e kane pasur ne shfrytëzime disa persona si shisha bare, po me intereson te di se tani çfare funksioni ka ky objekt dhe çka parashihni te bëni me të, sepse nëse vazhdoni ta leni kështu ky objekt mund te dëmtohet dhe ky objekt ka kushtuar për mbi 120000€.

z.Ruzhdi Shehu, objektin e valavices mendojmë ta japim për aktivitet te grave, për nevoja kulturore, trashëgimie, dhe jemi duke pritur se a po shprehin interesim dikush, ndërsa për kullën ne moronice, ju e dini se për te përfunduar duhet buxhet shtesë dhe jemi me shprese dhe kemi bere kërkesë ne ministrit e linjës, ne mënyrë qe ta përfundojmë ketë objekt, për momentin jemi duke e ndertuar nje kanalizim te ujërave te zeza.

z.Leonard Lllolluni, deshat ta pyes kryetarin se a ka drejtor qe i ka sjellur komunës se Junikut një donacion? Nese ka kush është dhe cilin projekt e ka sjellë.

z.Ruzhdi Shehu, po ka, por për momentin nuk i kam projektet përpara qe te di saktësisht por po ka, dhe se ne mbledhjen e radhës mundem te informoj.

z.Xhavit Velijaj, sa i përket donacionit te sjellur nga drejtorive, e kemi ndërtimin e çerdhes për fëmijë qe është donacion dhe është në proces te ndërtimit.

z.Lulzim Gacaferi, kur do te behet zërimi i asamblesë komunale në Junik kryesues? a ju ke drejtuar zyres se kryetarit apo drejtorisë se Administratës me shkrim, është i vetmi kuvend komunal ne Republikën e Kosovës pa zërim.

z.Shpejtim Gacaferi, pse duhet unë me be zërimin e asamblesë, edhe këtë sallë siç e menaxhon edhe tërë objektin e komunës e menaxhon drejtorja e administratës, dhe kjo nuk është çështje kryesuesit te kuvendit te Junikut, meqë jemi ne fund te mbledhjes, na ka mbetur ta shqyrtojmë edhe procesverbalin e muajt Qershor-2023, nëse nuk ka dikush ndonjë vërejtje atëherë kush është për? për 15 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoj se procesverbali i muajt Qershor 2023 u miratua. me kaq e shpalli te mbyllur mbledhjen e korrikut 2023.

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	2-155/8497
Një. Org.	2
Nr. i faq.	2
Data	12/09/2023

DATE/A:	12.09.2023
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi– Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ri-alokim të mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP) nr: 03/L-048, Ligjin e buxhetit për vitin 2023 dhe Ligjin për vetëqeverisje lokale, kërkojmë që të shtohet në rend dite në mbledhjen e ardhshme të KPF dhe te Kuvendit Komunal Kërkesa për rialokim te mjeteve te mbetura buxhetore për vitin 2023.

Të bashkangjitur në Kërkesë e keni raportin e përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa .

Raporti për rialokim të mjeteve të mbetura buxhetore për vitin 2023

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë (LMFPP) nr: 03/L-048, Ligjin e buxhetit për vitin 2023 dhe Ligjin për vetëqeverisje lokale, kërkojmë që të behet rialokimi i mjeteve të mbetura të pasqepnuara nga të hyrat vetanake në kategorinë e investimeve kapitale që të barten në të njëjtën kategori në të njëjtin nën program në projekte tjera.

Te hyrat vetanake (21) Investime Kapitale

Mjetet e mbetura nga projekti nr. 53877 nga Te hyrat vetanake në shume prej 3,439.25€
Planifikimi Urban dhe Mjedis (660) Nën programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66405)
kodi funksional (0620)

53877 Ndërtimi i kanalizimit sekondar për ujra të zeza lokacioni Bajraktar, 7 shtatori dhe Qender (3,439.25)

Ky projekt është i planifikuar për vitin 2023 në vlerë prej 50,000.00 (40,000.00 nga fondi burimor 10 Granti i Përgjithshëm dhe 10,000.00 nga fondi burimor 21 Te hyrat vetanake) dhe për përfundimin e këtij projekti nevojiten vetëm 43,375.00€ sipas kontratës së nënshkruar që do të thotë se mbesin të lira 6,625.00€, kurse për rialokim na nevojiten vetëm shuma prej **3,439.25 €**

Mjetet e Mbetura propozohen që të riallokohen

Planifikimi Urban dhe Mjedis (660) Nën programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66405)
kodi funksional (0620)

53439 Rekonstruimi i rrugës Gaxherr - Bajraktar

3,439.25€

Ky projekt është i planifikuar për vitin 2023 në vlerë prej 140,000.00 (110,000.00 nga fondi burimor 10 Granti i Përgjithshëm dhe 30,000.00 nga fondi burimor 21 Te hyrat vetanake) , kontrata e nënshkruar për këtë projekt është 137,395.00 i cili është përfunduar dhe janë kryer pagesat mirëpo lidhur me këtë projekt kemi pranuar një kërkesë për aprovim të punëve shtese në vlerë prej 6,044.25 €

Arsyctim: Kërkesa për rialokim të mjeteve të mbetura në kategorinë e investimeve Kapitale bëhet për arsye të shfrytëzimit maksimal të mjeteve të mbetura si dhe përfundimit të projekteve dhe shlyerjes së obligimeve sipas kontratave të nënshkruara.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

(Draft)
KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
KOMUNALE

2024- 2026

JUNIK, 2023

I. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR K.K – JUNIK

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po e paraqesim këtu është një dokument i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Shpenzimet janë planifikuar ashtu që të pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuar në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Hartimi i KAB-it 2024-2026 është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Buxhetore 2024/01 për Komunat, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ne kemi shqyrtuar KAB-in në kuptim të planifikimit afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- Strategjinë zhvillimore komunale;
- Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financim;
- Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe ;
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultatet e arritura.
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caqeve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2024-2026.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Junikut është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e cila është ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2024/2026 të dhëna nga MFPT përmes qarkores buxhetore 2024/01 .

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Junikut si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2024 – 2026, gjithnjë duke u bazuar në :

1. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
2. Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
